

---

**RREGULLORE NR. 2006/27**

**MBI SHPALLJEN E LIGJIT PËR PROCEDURËN E DHËNIES SË  
KONCESIONEVE TË MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (RKSKB) të datës 10 qershor 1999,

Në përputhje me kapitullin 8 dhe me nenet 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke marrë parasysh shkresën zyrtare nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës të datës 11 tetor 2005 lidhur me Ligjin për procedurën e dhënies së koncesioneve të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 3 tetor 2005,

Duke ditur se dispozitat e Ligjit nuk e cenojnë autoritetin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas RKSKB 1244 (1999) apo pushtetin dhe kompetencat e tij të rezervuara sipas Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe në veçanti sipas neneve 8.1(q) dhe 8.1(r) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

A. Me anë të kësaj shpall Ligjin për procedurën e dhënies së koncesioneve i miratuar nga Kuvendi i Kosovës (Ligji nr. 02/L-44), që i bashkëngjitet kësaj Rregulloreje, i cili bëhet i plotfuqishëm në datën e nënshkrimit, duke iu nënshtruar ndryshimeve në pjesën e mëposhtme B.

B. Përcakton se:

(a) Ligji zbatohet në përputhje të plotë me Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2002/12 të datës 13 qershor 2002 mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit,

(b) Në nenin 1, të fshihet përkufizimi “Organizatë biznesi” dhe të shtohet përkufizimi për shprehjen “Konzorcium” si më poshtë:

“ ‘Konzorcium’ do të thotë një grup i operatorëve ekonomikë”,

(c) Neni 2.1 të ndryshohet si vijon: “Nëse dispozitat e Ligjit për prokurim publik janë në përputhje me këtë Ligj, atëherë ato dispozita janë të zbatueshme.”,

(d) Dispozita e nenit 2.2 të fshihet dhe të zëvendësohet si në vijim: “Ky Ligj nuk e rregullon dhënien e koncesioneve në bazë të rregullimeve ose marrëveshjeve të posaçme të cilat parashohin rregulla dhe procedura tjera për prokurim, në rastet kur këto rregullime ose marrëveshje e kushtëzojnë disponueshmërinë e financimit të projekteve që i nënshtrohen dhënies së koncesioneve me zbatimin e këtyre rregullave dhe procedurave tjera, me kusht që këto rregullime ose marrëveshje të jenë arritur në mes të UNMIK-ut ose Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes dhe ndonjë qeverie të huaj, ndonjë organizate apo ndonjë institucioni financiar ndërqeveritar, bilateral, multilateral ose ndërkombëtar.”,

(e) Neni 3 të ndryshohet si vijon: “Nëse Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik (KRRP) vlerëson se ndonjë kontratë koncesioni është dhënë nga ndonjë autoritet kontraktues në kundërshtim me këtë Ligj, kjo kontratë është e pavlefshme. Megjithatë, KRRP-ja mund të vlerësojë se kjo kontratë është e vlefshme dhe e zbatueshme nëse (i) kontrata tashmë është realizuar në tërësi apo në masë të konsiderueshme dhe (ii) duke i marrë parasysh pasojat e mundshme për të gjitha interesat të cilat ka gjasa të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik, ai vjen në përfundim se pasojat negative i tejkalojnë përfitimet të cilat mund të arrihen. Në këto raste, KRRP-ja e ka autoritetin për të ndërmarrë çfarëdo masash që ai i konsideron të nevojshme për të siguruar se autoriteti kontraktues në fjalë pas kësaj t’u përmbahet me përpikëri kushteve të këtij Ligji.”,

(f) Në nenin 5.4 d., fjala “korporatë” të zëvendësohet me “një subjekt juridik të pavarur të themeluar dhe të inkorporuar në bazë të ligjit në fuqi në Kosovë”,

(g) Në nenin 11.2 a., fjalët “dhe, nëse është paraparë një gjë e tillë në kërkesën për propozime, para skadimit të këtij afati” të fshihet,

(h) Dispozita e nenit 18 d. të fshihet dhe të zëvendësohet si në vijim: “Kur kontrata mund t’i jepet vetëm një ofertuesi të caktuar për arsye teknike apo arsye tjera objektive, ose për arsye valide juridike të cilat kërkojnë respektimin e të drejtave ekskluzive.” Neni 18 të rinumërohet si neni 18 (1) dhe pas paragrafit (1) të shtohet paragrafi i ri (2) si në vijim: “KRRP-ja e nxjerr vendimin jo më vonë se dhjetë (10) ditë pune pas marrjes së kërkesës për miratim nga autoriteti

kontraktues. Nëse brenda kësaj periudhe KRRP-ja nuk nxjerr vendimin, kërkesa konsiderohet të jetë e miratuar.”,

(i) Në nenin 30, fjala “organizatë biznesi” të zëvendësohet me “një subjekti juridik të pavarur të inkuorporuar në bazë të ligjeve të Kosovës”,

(j) Në nenin 31, fjala “publike” të zëvendësohet me “në pronësi publike dhe shoqërore”,

(k) Në nenin 33.2, të shtohet një presje pas fjalës “projekt”,

(l) Në nenin 40, të shtohet paragrafi i tretë si në vijim: “Koncesionari ka të drejtë në rishikimin e kontratës për koncesion me qëllim të mundësimit të përshtatjeve financiare të duhura në rast të rritjes së shpenzimeve të cilat dalin nga kërkesat e palës kontraktuese, që nuk janë paraparë fillimisht me kontratën për koncesion, nëse këto kërkesa shtesë i rrisin në masë të konsiderueshme shpenzimet e realizimit të kontratës apo nëse e zvogëlojnë në masë të konsiderueshme vlerën të cilën e merr koncesionari për realizimin e saj.”.

Këto ndryshime të përcaktuara në (b) deri në (l) do të pasqyrohen në tekstin përfundimtar zyrtar të Ligjit.

Nënshkruar sot, më 27 prill 2006.

Søren Jessen-Petersen  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm